

## NË EMËR TË POPULLIT

**GJYKATA THEMELORE NE PRIZREN – Departamenti i pergjithshem Penal**, gjyqtari i vetem gjyques Fatmir Krasniqi me sekretaren juridike Fatime Bajraktari, në lëndën penale kundër të akuzuarit F. D. nga Prizreni, për shkak të veprës penale vjedhje e sherbimeve komunale nga neni 320 të KP-së, sipas aktakuzes së Prokurorise Themelore në Prizren PP.nr.1948-4/2016 të dt. 07.10.2016, pas mbajtjes së seancës fillestare publike, në prezencën e Prokurorit Themelore në Prizren Besim Susuri, të akuzuarit, me datë **18.09.2017**, mori dhe shpalli publikisht këtë:

### AKT GJYKIM

I akuzuari F. D., nga i ati Xh., e ëma Sh., e vajzërisë Q., i lindur më \_\_\_\_\_ në Prizren, tani me banim ne Prizren rr. nr. , i martuar baba i 4 femijeve, penzioner, i gjendjes se dobet ekonomike, me shkolle te mesme te kryer, me kombesi shqiptar, shtetas i R. se Kosoves.

### ËSHTË FAJTOR

Se prej dates se pavertetuar e deri me dt.23.05.2016, ne Prizren, pikerisht ne shtepin e tij perfiton nga ndonje sherbim komunal, qe furnizohet permes rrjetit perçues te rrymes apo rrjetit te shperndarjes, pa autorizimin e furnizuesit te autorizuar, ne ate menyre qe shfrytezon energjin elektrike ne menyre direkte, para njehsorit elektrik permes degezimit, ashtu qe energjia elektrike e shpenzuar nuk regjistrohet me ç'rast ndermarrjes se demtuar KEDS –Departamentit ligjo ne Prizren, i ka shkaktuar dem material.

-kësodore ka kryer veprën penale vjedhje e sherbimeve komunale nga neni 320 të KP-së.

Andaj, gjykata në bazë të nenit 7, 41,46, 49 par.1 p.1.1, 50, 73, 74, 75, e 76 e 80 dhe 365 të KPK-ës, andaj i shqipton,

### DENIM ME GJOBË

Ne lartesi prej **150 euro**, i cili denim nuk do te ekzekutohet ne afatin prej 1 viti nga dita e plotefuqishmeris se ketij aktgjykimi, nese i akuzuari nuk kryen veper tjeter penale, dhe

### DENIM ME KUSHT

Per vepron penale si ne dispozitiv te aktakuzes duke i vërtetuar dënimin me burgim në kohëzgjatje prej **3 (tre) muajve**, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse në afatin prej **1 (nje) viti**, nga dita e plotefuqishmerise se ketij aktgjykimi, i akuzuari nuk do te kryene ndonjë vepër të re penale.

I akuzuari obligohet qe ti paguaje shpenzimet e procedurs penale sado qe te jene ato, ne emer te shpenzimeve te paushallit gjyqesor shumen prej **20 euro**, te gjitha keto ne afate prej 15 diteve pas plotfuqishmerise se ketij aktgjykimi.

Perfaqesuesja juridike e te demtuares Kek- distrikti ne Prizren nga Prizreni, per realizimin e kerkeses pasuroro juridike udhezohet ne kontest te rregullt civilo juridik.

### Arsyetime

Prokuroria Themelore ne Prizren, kesaj gjykate i ka parashtruar aktakuze me PP.nr. PP.nr.1948-4/2016 të dt. 07.10.2016, kunder te akuzuarit F D<sup>o</sup> ng<sup>a</sup> Prizreni, per shkak te vepres penale vjedhje e sherbimeve komunale nga neni 320 te KP-es.

Gjykata ne shqyrtim kryesor ka vertetuar gjendjen e ketille faktike nga pranimi i fajesise nga ana e te akuzuarit i cili vullnetarisht e ka pranuar fajesin, per shkak te se ciles gjykata fare nuk ka administruar provat. Sipas detyres zyrtare gjykata nuk gjeti se ekziston ndonje prove e pa pranueshme, gjithashtu gjykata ne teresi ka verteuar se i akuzuari ka kuptuar natyren dhe pasojat e pranimit te fajesis per vepren penale e cila i vihet ne bare, e qe pranimi i fajesis eshte bere ne menyre vullnetare dhe pa kushtezime, duke u mbeshtetur ne fakte dhe prova materiale te cilat jane paraqitur ne aktakuze, per te cilat i akuzuari ka qene i njofshuar me te gjitha provat materiale. Gjykata ka ardhje ne perfundim, se pranimi i fajesise nga ana e te akuzuarit eshte bere ne pajtim me nenin 248 te KPPK-se, dhe faktet qe permban aktakuza, ne veprimet e te akuzuarit formohen te gjitha elementet e vepres penale, te vjedhjes se sherbimeve komunale nga neni 320 te KP-se, dhe per kete gjykata te akuzuarin i shpalli fajtor dhe i shqiptoi denimin me kusht, paraprakisht duke i vertetuar pergjegjesin e tije penalo-juridike.

Me rastin e caktimit te denimit ndaj te akuzuarit gjykata vleresoi te gjitha rrrethanat ne kuptim te nenit 73 te KPK-se te cilat ndikojne ne llojin dhe lartesine e denimit, duke mos e gjetur rrrethanat posaquerisht renduese, e si rrrethane lehtesuese eshte marre pranimi i fajesise nga ana e te akuzuarit, sjelljen korrekte pas kryerjes se vepres penale, pendimi i thelle i tije, deri me tanin i pa gjykuar, çka nenkupton se nuk ka ardhur ndesh me rregullat pozitive, si dhe ne kuptim te nenit 74, 75 e 76 gjykata morri parasysh bashkepunimin e te akuzuarit me gjykaten i cili bashkepuni ka qene vullnetar, ka shprehur keqardhje per vepren penale te kryer, e ka kryer pagesen e demit te shkaktuar te demtuarit keds, eshte i gjendjes se dobet ekonomike, penzioner, i martuar babai 4 femijeve, andaj gjykata i shqiptoi denimin me kusht sepse konsideron se me shqiptimin e denimit do te arrihet qellimi i denimit, prandaj i shqipton denimin me kusht, dhe i verteton denimin me burgim ne kohezgjatje prej **3 (tre) muajve**, i cili denim nuk do te ekzekutohet ne afatin prej **1 (nje) viti**, nese i akuzuari nuk kryene veper te re penale, duke menduar se denimi i shqiptuar i per gjigjet shkalles se pergjegjesise se tije dhe me kete denim do te arrihet qellimi i denimit qe ne te ardhmen te jete i kujdeshhem dhe do te permabahet nga veprimet e tilla te karakterit penal.

Vendimi mbi shpenzimet procedurale gjykata e bazoi ne kuptim te nenit 454 te KPPK-se.

Si u cek edhe me lartë u vendos si në shqiptim të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN**

P.nr. 2140/2016 të dt. 18.09.2017

**Sekretare Juridike  
Fatime Bajraktari**

Republika e Kosovës

Republika Kosovo

Kosova Cumhuriyeti

Gjyqtari

**Fatmir Krasniqi**

SAKTËSINË E KOPJËS E VËRTE

TAÇNOST OTPRAYKA POTVRDJUJE

BU KOPYANIN ASLMA UYGUN OLDUGU TASDIK EDUR

Punëtori i autorizuar

Ovlašćeni radnik

Yetkili işçi

**UDHËZIM JURIDIK:** Kunder ketij aktgykimi palet e pakenaqura kane te drejte ankese ne afat prej 15 diteve nga dita e marrjes se te njejtes, Gjykates se Apelit ne Prishtine nepermjet te kesaj gjykate.